



REPUBLIKA E SHqipëRISE

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 128 Prot

Tiranë, më 20.09, 2010

VENDIM Nr. 16 dt. 31.08.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 31.08.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve.

1. Miratohet "Rivitalizimi i sheshit "ILIRIA", faza e I, (Shkallaret)" me kondicionin:

- Punimet në shkallare të bëhen me gur.
- Punimet të jenë nën mbikëqyrjen e ASHA-s.
- Nëse gjatë zbatimit të projektit do të dalin gjurmë të bazilikës ose të murit të fazës turke këto të ekspozohen si Trashëgimi Kulturore.
- KKR nuk miraton lokalitë të shërbimit të parashikuar në projekt pranë murit mesjetar pasi hyn në kontradiktë me vetë vlerën që ka objekti.
- Ky miratim i KKR jepet vetëm për fazën e I-rë sipas projektit me shumë faza të paraqitur nga Bashkia Durrës. Projektet e ndërhyrjes për fazat e tjera duhet të paraqiten në KKR për shqyrtim dhe miratim.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE